



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupšina Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

**KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA
P R O C E S V E R B A L**

Mbledhja e komitetit për **Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e dyta** me radhë, e mbajtur me datë **03.05.2024 (e premte)**, me fillim në ora **10:00**.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e komitetit, **znj. Almedina Jaha**. Të gjithë anëtarët e komitetit ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2024;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesja: Mirëmëngjesi! Përshëndetje për të gjithë! Jemi mbledhur sot në takimin e dytë të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, vazhdojmë me leximin e rendit të ditës. Atëherë, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim! Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja: Atëherë, nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet procesverbali, pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2024;

Kryesuesja: Ne e kemi bërë një plan. Do ta lexoj në pika të shkurta. Në hyrje janë disa informacione për persona me aftësi të kufizuara. Në Komunën e Rahovecit, numri i personave me aftësi të kufizuara është rreth 1006. Ky komitet është përzgjedhur nga kuvendi komunal i Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2024. Qëllimi i komitetit është adresimi i çështjeve të qytetarëve tek zyrtarët komunalë. Funksonet që do të kryhen nga ky komitet, do të jenë: Dhënia e propozimeve të ndryshme tek autoritetet komunale, hulumtime të ndryshme, iniciativa, ide, paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve te kryetari i komunës dhe propozime për zgjidhjen e problematikave të identifikuara. Qëllimi tjetër i komitetit është nxitja, mbrotja dhe sigurimi i mundësisë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara në territorin e Komunës së Rahovecit, t’i gëzojnë ato në mënyrë të barabartë. Realizimi i këtij programi, do të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Rahovecit, të kenë një adresë të caktuar ku t’i ngrisin çështjet që ata ballafaqohen në jetën e përditshme. Komiteti përherë do të jetë për target personat me aftësi të kufizuara në territorin e Komunës së Rahovecit. Për t’i arritur këto qëllime, ne si grup e kemi punuar planin 1 vjeçar të komitetit. Bazuar në nenin 11 të udhëzimit administrativ për procedurën e themelimit dhe organizimit të komiteteve, do të organizohen së paku 6 mbledhje në vit. Për vitin 2024 mbledhjet janë të parapara, në mars, maj, qershor, tetor, nëntor dhe dhjetor. Komiteti do të organizojë së paku një tryezë të rrumbullakët, me qëllim të identifikimit dhe diskutimit të çështjeve që ballafaqohen personat

me aftësi të kufizuara. Do të realizohen vizita edhe nëpër OJQ të ndryshme, si: Hendikos, Hareja, SHL, Shoqata e të Verbërve etj... Do t'i bëjmë vizitë komiteteve të vendeve të tjera, në Gjakovë dhe Pejë. Të parapara janë edhe vizitat në shkolla: "Isa Boletini" në qytete, në shkollë të Krushës dhe Ratkocit. Në plan janë të përfshiera edhe aktivitetet sensibilizuese: Shënimi i ditës ndërkombëtare për persona me aftësi të kufizuara (3 dhejtor). Do të ketë gara sportive, shah apo sport tjetër. Të parapara janë edhe trajnimet. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve do të tentohet që anëtarët e këtij komiteti të marrim pjesë në ndonjë trajnim në Kosovë, që organizohen nga organizatat e ndryshme vendore, apo ndërkombëtare.

Atdhe Rama: Kur e kemi hartuar këtë plan, jemi bazuar te praktikat e qyteteve tjera në Kosovë. Jemi munduar t'i vendosim disa pika që mund të jenë të realizueshme dhe që mbështeten prej institucioneve komunale dhe prej OJQ-ve. Shpresojmë që të gjitha pika të zbatohen në përpikmëri. E kemi vullnetin e madh që deri në fund të vitit këto pika të realizohen, vetëm na duhet mbështetje e ndonjë organizate. Në raportin final të fundvitit do ta shfaqim një rezultat të kënaqshëm për të dy palët, për personat me aftësi të kufizuara dhe për të gjithë mbështetësit tanë.

Skender Hamza: Përshëndetje për kryesuese, zëvendëskryesuesin, KFOR-in, anëtarët e komitetit, koleget nga zyra e informimit, kolegun Albion. Plani është i mirë. Realisht planet bëhet me pika të rendit të ditës, Psh: Pikë standarde duhet të jetë aprovimi i procesverbalit, vizitat e parapara, trajnimet, aktivitetet, dita botërore për persona me aftësi të kufizuara etj... Në plan të punës duhet të parashihen këto pika.

Atdhe Rama: Faleminderit për këto vërejtje, Skender! I kemi diskutuar edhe këto plane të detajizuara dhe nëse aprovohet ky plan i punës, do t'i specifikojmë të gjitha aktivitetet.

Skender Hamza: Thash që plani është shumë i mirë dhe voluminoz, por është më e lehtë për kryesuesen që të specifikohen pikat në plan të punës për secilën mbledhje.

Kryesuesja: Faleminderit! Atëherë, po e vendosim në votim planin e punës. Kush është "për"?... Me shumicë unanime aprovohet plani. Faleminderit shumë.

3. Të ndryshme;

Kryesuesja: A ka dikush diçka në lidhje me pikën e fundit?

Atdhe Rama: Propozoj që t'ia fillojmë aktivitetet tona me vizita te OJQ-të në komunën tonë, të cilat janë të lidhura me punën e personave me aftësi të kufizuara. Me informatat që ne i mbledhim nëpër këto vizita, do t'i fillojmë takimet me institucionet lokale, duke kërkuar bashkëpunim sa më të madh.

Skender Hamza: Propozimi i Atdheut, ndërlihet me atë që thash rreth planit. Komiteti për Arsim dhe Shëndetësi, pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës për mbledhjen përkatëse, punën e vazhdon në terren me veturë zyrtare për vizita të ndryshme, që paraprakisht janë të cekura në rend dite.


Atdhe Rama: Kjo është arsyeja që e kemi shkruar në plan të punës që kemi nevojë të kemi edhe takime me komitetet tjera brenda vendit. Nëse është e mundur të gjejmë ndonjë donator apo bashkëpunëtor, që ne të shkojmë nëpër vizita të tilla, duke e marrur edhe eksperiencën e qyteteve tjera. Qëllimi ynë është që pjesëtarët e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara të ndihen dhe të jetojnë hap pas hapi njëjtë si në shtetet e zhvilluara.

Kryesuesja: Faleminderit Atdhe! A ka dikush diçka për fund? Nëse jo, atëherë takimi për sot përfundoi. Ju përshëndes dhe shihemi në takimin e radhës.

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi

Kryesuesja e komitetit;


Almedina Jaha

